

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Pasqyrat Financiare të përgatitura në përputhje me

Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

me Raportin e Auditorit të Pavarur

Përmbajtja

Raporti i Auditorit të Pavarur.....	1-2
Pasqyra e pozicionit financiar.....	3
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.....	5
Pasqyra e rrjedhjes së parasë.....	6
Shënime të pasqyrave financiare.....	7-37
Skedulet suplementare.....	a-d

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për aksionarin e Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10000 Pristina
Kosovo
T +383 (0)38 247 801
F +383 (0)38 247 802
E Contact@ks.gt.com
VAT No. 330086000

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit..

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2020, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë të përshkruara në mënyrë më të detajuar në paragrafin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne poashtu kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë..

Informacione tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat tjera. Informatat tjera përfshijnë shtojcat plotësuese të cilat përfshijnë "Marxhinën e solvencës" dhe " Pasuritë që mbulojnë detyrimet e sigurimeve ".

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon edhe informatat tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë formë sigurie apo konkluzioni mbi to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat tjera dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra gjatë auditimit ose në të kundërtën duket të jetë materialisht keqdeklaruar. Nëse, bazuar në punën që kemi kryer konkludojmë se ekziston një anomali materiale e këtyre informatave tjera, neve na kërkohet ta raportojmë atë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë aspekt.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF -të, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga gabimi apo mashtrimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyrave financiare.


Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së parimit së vijmësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Kompania mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të terheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Kompania të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijmësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.A, përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Prishtina




Suzana Stavrikj
Statutory auditor


30 April 2021


SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
PASURITË			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	9	228,538	161,499
Depozitat me afat në banka	10	4,316,597	4,270,163
Investime në letra me vlerë	11	354,163	354,179
Të arkëtueshmet siguroese	12	615,960	636,003
Te arkëtushme nga tatimi në të ardhura		9,477	-
Pasuri të risigurimit		8,706	7,490
Shpenzimet e shtyra të përvetësimit	13	10,826	15,758
Parapagimet		-	17,500
Pasuritë tjera		-	7,971
Pajisjet dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	14	6,398	32,090
Asetet e paprekshme	15	16,062	15,541
GJITHSEJ PASURITË		5,566,727	5,518,196
DETYRIMET			
Detyrimet për kontratat e sigurimit	16	459,041	455,469
Rezerva për primet e pafituara	17	276,417	257,259
Detyrime të tjera	18	139,915	136,868
Tatimi i pagueshem		5,000	6,000
Detyrimi i qirasë (SNRF 16)	14	1,489	29,066
GJITHSEJ DETYRIMET		881,862	884,661
KAPITALI			
Kapitali aksionar	19	3,500,000	3,500,000
Fitimet e mbajtura		1,184,865	1,133,534
GJITHSEJ KAPITALI AKSIONAR		4,684,865	4,633,534
GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI AKSIONAR		5,566,727	5,518,196

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga menxhmenti i Kompanisë më datë 30 prill 2021 dhe u nënshkruan nga:


 Z. Perparim Drini
 Drejtor i përgjithshëm


 Znj. Vlera Halili
 Drejtore e financave

Shënimet në faqet 7 deri në 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Prime të shkruara bruto	20	1,073,175	1,116,295
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara bruto	18	(19,158)	(97,339)
Primet e fituara bruto, neto nga tatimi në të ardhurat e korporatave		1,054,017	1,018,956
Prime të ceduara të risiguruesit		(12,611)	(11,437)
Rezerva e risiguruesit për primet e pafituara		1,216	6,007
Primet e fituara neto		1,042,622	1,013,526
Të ardhurat nga interesi	10,11	85,227	77,354
Të ardhura të tjera		-	1,067
Të ardhura neto		1,127,849	1,091,947
Ndryshimi në rezervë	17	(3,572)	(65,758)
Dëmet e paguara	17	(299,273)	(186,976)
Dëmet e sigurimit, neto		(302,845)	(252,734)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	21	(427,223)	(378,515)
Shpenzime administrative	22	(305,463)	(227,810)
Rënia në vlerë e të arkëtueshmeve të sigurimeve	12	(25,394)	(15,412)
Fitimi para tatimit		66,924	217,476
Tatimi në të ardhura aktual		(15,687)	(47,254)
Fitimi neto për periudhën		51,237	170,222
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		51,237	170,222

Shënimet në faqet 7 deri në 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2019	3,500,000	963,312	4,463,312
Transaksionet me pronarët	-	-	-
Fitimi neto për vitin	-	170,222	170,222
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	170,222	170,222
Gjendja më 31 dhjetor 2019	3,500,000	1,133,534	4,633,534
Korrigjimi i gjendjes fillestare	-	94	94
Më 1 janar 2020 rideklaruar	3,500,000	1,133,628	4,633,628
Transaksionet me pronarët	-	-	-
Fitimi neto për vitin	-	51,237	51,237
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	51,237	51,237
Gjendja më 31 dhjetor 2020	3,500,000	1,184,865	4,684,865

Shënimet në faqet 7 deri në 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimi	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit		51,237	170,222
<i>Rregulluar për :</i>			
Zhvlerësimin	14,15	30,362	30,025
Shpenzimet e tatimit në të ardhurat e korporatave		15,687	47,254
Të ardhurat nga interesi		(85,227)	(77,354)
		12,059	170,145
(Rritje)/rënie në rezervën e risiguruesit për primet e pafituara		(1,216)	(6,006)
(Rritje)/rënie në llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimeve		24,463	(214,335)
Rënie në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		4,931	5,189
Rënie në detyrimet për kontratat e sigurimit		(3,767)	65,758
Rritje në rezervat për primet e pafituara		19,158	97,339
Rritja/(rënie) në detyrimet e tjera		(3,973)	47,125
Rritje/rënie në detyrim për qera		-	-
Rritje në parapagime dhe pasuri tjera		25,471	(17,171)
		51,926	172,094
Interesi i arkëtuar		38,810	84,184
Tatimi i paguar në të ardhurat e korporatave		(26,164)	(52,701)
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga veprimtaritë operative		64,572	203,577
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese			
Blerja e pajisjeve		2,467	(10,881)
Rritje në depozitat me afat me banka		-	(100,000)
Rënie në depozitat e bankës		-	50,000
Rrjedha e parasë e përdorur në veprimtaritë investuese		2,467	(60,881)
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë financuese			
Rritja në detyrimet e qirasë, ndikimi neto	14	(25,200)	(30,000)
Dividenda e paguar		-	(200,000)
Paraja neto (e përdorur në) veprimtaritë financuese		(25,200)	(230,000)
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të parasë		67,039	(57,304)
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		161,499	218,803
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	9	228,538	161,499

Shënimet në faqet 7 deri në 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a ("Kompania") është një shoqëri aksionare e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Regjistrimit të Bizneseve më 10 maj 2011. Kompania është themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 dhe rregullit 31 të Bankës Qëndrore të Kosovës për licencimin e kompanive të sigurimit të jetës në Kosovë të datës 18 dhjetor 2007. Kompania zotërohet nga Sigal Uniqa Group Austria Sh.a, një Kompani shqiptare, Kompania mëmë e së cilës është Uniqa Osterreich Versicherungen AG, Austri ("UNIQA" ose "Pala kontrolluese përfundimtare"), një shoqëri aksionare e themeluar dhe e vendosur në Republikën e Austrisë. Kompania ofron shërbime të sigurimit të jetës si sigurimi personal, sigurimi i jetës me afat, sigurimi i jetës me kredi dhe sigurimi i jetës me kursim. Adresa e regjistruar e Kompanisë dhe vendi i biznesit është Rr. "Pashko Vasa", nr.15, Prishtinë, Kosovë. Më 31 dhjetor 2020, Kompania kishte 12 punonjës (2019: 11)

Menaxhmenti i Kompanisë

Menaxhmenti i Kompanisë gjatë vitit 2020 dhe deri në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, përbëhet nga:

Perparim Drini	Drejtor i Përgjithshëm
Dardan Nimani	Zv. Drejtor i Përgjithshëm
Vlera Halili	Drejtoreshë e Financave

Bordi Mbikëqyrës gjatë vitit 2020 dhe deri në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, përbëhet nga:

Avni Ponari	Kryetar
Klement Mersini	Anëtar
Abdyl Sarja	Anëtar
Elvis Ponari	Anëtar
Sairimir Dharmo	Anëtar
Perparim Drini	Anëtar pa te drejtë vote

2. Bazat e përgatitjes

Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të cilat janë lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) sipas konventës së kostos historike. Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur thuhet ndryshe (shih Shënimet 3 dhe 4 për miratimin e standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara dhe deklaratave të reja kontabël të miratuara nga Kompania).

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kontabël. Ajo gjithashtu kërkon që menaxhmetni të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë të shpalosura në Shënimin 6.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, që është monedha funksionale e Shoqërisë dhe monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon Kompania.

Implikimet e COVID-19 në politikat dhe vlerësimet e rëndësishme të kontabilitetit

Për shkak të pandemisë COVID-19, e cila ka pasur një ndikim të rëndësishëm në tregjet ekonomike dhe financiare, Kompania gjithashtu konsideroi përshtatshmërinë e politikave të llogaritjes, vlerësimeve dhe supozimeve të përdorura në vitin 2020 dhe vlerësoi ndikimin në pozicionin e saj financiar, rrjedhjet e parave dhe fitimi ose humbja.

Verifikimi i supozimeve të parimit të vijimësisë

Menaxhmenti ka konsideruar pasojat e COVID-19, ngjarjeve dhe kushteve të tjera dhe ka përcaktuar se ato nuk krijojnë një pasiguri materiale që hedh dyshime të mëdha mbi aftësinë e Kompanisë për të vazhduar parimin e vijimësisë. Kompania arriti të sigurojë një shitje të mirë dhe normë rinovimesh gjatë vitit 2020, dhe kjo siguroi një vazhdim të qëndrueshëm të biznesit. Në përgjithësi, operacionet e nivelit të primit dhe likuiditetit të kompanisë

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Implikimet e COVID-19 në politikat dhe vlerësimet e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

nuk u ndikuan shumë pasi ato mbetën të qëndrueshme. Ndikimi negativ i COVID-19 ishte në dëmet e paguara (kur arsyeja e vdekjes ishte COVID 19). Pjesa më e madhe e portofolit të klientëve të Kompanisë ka të bëjë me Sigurimin e Jetës së Kredive të cilat janë politika të lidhura me hua të cilat kanë një normë të lartë rinovimi çdo vit, e cila është edhe më e intensifikuar gjatë vitit 2020 dhe tre muajve në vijim të vitit 2021. Menaxhmenti i Kompanisë pret që të ketë ndikim pozitiv në biznes në periudhën vijuese.

Për më tepër, mbahet likuiditeti i duhur i Kompanisë (pozicioni neto i likuiditetit më 31 Dhjetor 2020 është 4,806,538 euro, (31 dhjetor 2019: 4,739,499 euro), dhe mjaftueshmëria e kapitalit të Kompanisë vlerësohet e fortë dhe mbi kërkesat minimale ligjore.

Në bazë të të gjitha llogaritjeve të paraqitura, mund të konfirmohet se supozimi i parimit të vijimësisë është i përshtatshëm.

Rënia në vlerë dhe matja e vlerës së drejtë të pasurive financiare

Asnjë ndryshim i rëndësishëm në tregjet financiare nuk ka ndodhur në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2020 që do të ndryshonte matjen e pasurive financiare, veçanërisht në lidhje me përshtatshmërinë e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare.

Sa i përket të arkëtueshmeve, është verifikuar përshtatshmëria e kriterëve për lejimin. Meqenëse nuk kishte ndonjë rritje të ndjeshme në llogaritë e arkëtueshme, u vlerësua se kriteret e përdorura në vitin 2019 ishin të përshtatshme. Asnjë humbje nga rënia në vlerë nuk u njoh midis pasurive të tjera.

Ndryshimet në vlerësimet e kontabilitetit dhe verifikimet e tjera

Nuk ka pasur ndryshime në supozimet e përdorura në llogaritjen e rezervave matematikore dhe rezervave të tjera.

3. Standardet e reja kontabël

Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara që janë lëshuar, por jo ende efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Kompanisë shpalosen më poshtë. Kompania synon të miratojë këto standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara, nëse zbatohen, kur ato të bëhen efektive.

Ndryshimet në SNK 1: Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose joaktuale

Në janar 2020, BSNK lëshoi ndryshime në paragrafët 69 deri 76 të SNK 1 për të specifikuar kërkesat për klasifikimin e detyrimeve si aktuale ose joaktuale. Ndryshimet sqarojnë:

- Çfarë nënkuptohet me të drejtën për të shtyrë zgjidhjen
- Se e drejta për shtyrje duhet të ekzistojë në fund të periudhës së raportimit
- Ky klasifikim nuk preket nga gjasat që një njësi ekonomike të ushtrojë të drejtën e saj të shtyrjes
- Kjo vetëm nëse një derivat i lidhur në një detyrim të konvertueshëm është vetë një instrument i kapitalit neto, kushtet e një detyrimi nuk do të ndikonin në klasifikimin e tij

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023 dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive.

Referenca në Kuadrin Konceptual - Ndryshimet në SNRF 3

Në maj të vitit 2020, BSNK lëshoi ndryshime në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit - Referencë në Kuadrin Konceptual. Ndryshimet kanë për qëllim të zëvendësojnë një referencë në Kornizën për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare, të lëshuar në 1989, me një referencë në Kornizën Konceptuale për Raportimin Financiar të lëshuar në mars 2018 pa ndryshuar ndjeshëm kërkesat e saj. Bordi gjithashtu shtoi një përjashtim në parimin e njohjes së SNRF 3 për të shmangur çështjen e fitimeve ose humbjeve të mundshme të 'ditës 2' që lindin për detyrimet dhe detyrimet e kontigjente që do të ishin brenda objektivit të SNK 37 ose KIRFN 21 Taksat, nëse ndodhin veçmas. Në të njëjtën kohë, Bordi vendosi të sqarojë udhëzimet ekzistuese në SNRF 3 për pasuritë e detyruara që

3. Standardet e reja kontabël (vazhdim)

Referenca në Kuadrin Konceptual - Ndryshimet në SNRF 3 (vazhdim)

nuk do të ndikohej nga zëvendësimi i referimit në Kornizën për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 dhe zbatohen në mënyrë të mundshme. Ndryshimet nuk pritet të kenë një ndikim material në Kompani.

Prona, impiantet dhe pajisjet: Të ardhurat para përdorimit të synuar - Ndryshimet në SNK 16

Në maj të vitit 2020, BSNK lëshoi Pronë, Impiant dhe Pajisje - Të ardhura para përdorimit të synuar, i cili ndalon njësitë ekonomike të zbresin nga kostoja e një elementi të pasurive afatgjata materiale, çdo të ardhur nga shitja e sendeve të prodhuara ndërsa e sjell atë pasuri në vendndodhje dhe kusht i domosdoshëm që ai të jetë i aftë të funksionojë në mënyrën e parashikuar nga menaxhmenti. Në vend të kësaj, një njësi ekonomike njeh të ardhurat nga shitja e artikujve të tillë dhe kostot e prodhimit të këtyre artikujve, në fitim ose humbje.

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022 dhe duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive për zërat e pasurive afatgjata materiale të vendosura në dispozicion për përdorim në ose pas fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur kur njësi ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin. Ndryshimet nuk pritet të kenë një ndikim material në Kompani.

Kontrata të rënda - Kostot e përmbushjes së një kontrate - Ndryshime në SNK 37

Në maj të vitit 2020, BSNK lëshoi ndryshime në SNK 37 për të specifikuar se cilat kosto duhet të përfshijë një njësi ekonomike kur vlerëson nëse një kontratë është e rëndë ose humbëse. Ndryshimet zbatojnë një "qasje të lidhur drejtpërdrejt me kostot". Kostot që lidhen drejtpërdrejt me një kontratë për të siguruar mallra ose shërbime përfshijnë si kostot rritëse ashtu edhe një alokim të kostove që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e kontratës. Kostot e përgjithshme dhe administrative nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me një kontratë dhe përjashtohen nëse nuk i ngarkohen palës tjetër në mënyrë të qartë sipas kontratës.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Ndryshimet nuk pritet të kenë një ndikim material në Kompaninë.

SNRF 1 Adaptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Filiali si adaptues për herë të parë

Si pjesë e përmirësimeve të saj vjetore 2018-2020 në procesin e standardeve të SNRF, BSNK lëshoi një ndryshim në SNRF 1 Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Ndryshimi lejon një filial që zgjedh të zbatojë paragrafin D16 (a) të SNRF 1 për të matur ndryshimet kumulative të përkthimit duke përdorur shumat e raportuara nga shoqëria mëmë, bazuar në datën e kalimit të prindit në SNRF. Ky ndryshim zbatohet gjithashtu për një ndërmarrje të përbashkët ose të përbashkët që zgjedh të zbatojë paragrafin D16 (a) të SNRF 1.

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me leje adoptimi më të hershme. Ndryshimet nuk janë të zbatueshme për Kompaninë.

SNK 41 Bujqësia - Taksimi në matjet e vlerës së drejtë

Si pjesë e përmirësimeve të saj vjetore 2018-2020 në procesin e standardeve të SNRF, BSNK lëshoi ndryshimin në SNK 41 Bujqësia. Ndryshimi heq kërkesën në paragrafin 22 të SNK 41 që njësitë ekonomike të përjashtojnë rrjedhjet e parave për tatim kur matin vlerën e drejtë të pasurive brenda objektit të SNK 41.

Një njësi ekonomike zbaton ndryshimin në mënyrë të mundshme për matjet e vlerës së drejtë në ose pas fillimit të së parës

periudha vjetore e raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2022 me lejim të hershëm të adaptimit. Ndryshimet nuk janë të zbatueshme për Kompaninë.

3. Standardet e reja kontabël (vazhdim)

b. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar ende nga Kompania

SNRF 17 Kontratat e Sigurimit

SNRF 17 është efektiv për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023, me shifrat krahasuese të kërkuara. Zbatimi i hershëm është i lejuar, me kusht që njësi ekonomike të zbatojë gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 në ose para datës që zbaton për herë të parë SNRF 17.

SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili u soll si standard i përkohshëm në 2004. SNRF 4 u ka dhënë kompanive shpërndarje për të vazhduar kontabilitetin për kontratat e sigurimit duke përdorur standardet kombëtare të kontabilitetit, duke rezultuar në një mori qasjesh të ndryshme.

SNRF 17 zgjidh problemet e krahasimit të krijuara nga SNRF 4 duke kërkuar që të gjitha kontratat e sigurimit të llogariten në një mënyrë të qëndrueshme, duke përfutur si investitorë ashtu edhe kompani sigurimesh. Detyrimet e sigurimit do të kontabilizohen duke përdorur vlerat aktuale, në vend të kostos historike.

Kompania pret që standardi i ri, kur zbatohet për herë të parë, të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Kompanisë.

SNRF 9 "Instrumentet financiare" - Tarifat në testin e '10 përqind' për mosnjohjen e detyrimeve financiare

(Në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).

Si pjesë e përmirësimeve të saj vjetore 2018-2020 në procesin e standardeve të SNRF, BSNK lëshoi ndryshimin në SNRF 9. Ndryshimi sqaron tarifën që një njësi ekonomike përfshin kur vlerëson nëse kushtet e një detyrimi të ri financiar të ri ose të modifikuar janë thelbësisht të ndryshëm nga kushtet e detyrimit origjinal financiar. Këto tarifa përfshijnë vetëm ato të paguara ose të marra nga huamarrësi dhe huamarrësi, duke përfshirë tarifën e paguara ose të marra nga huamarrësi ose huamarrësi në emër të tjetrit. Një njësi ekonomike zbaton ndryshimin në detyrimet financiare që modifikohen ose shkëmbehen në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësi ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin.

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me leje adoptimi më të hershme.

Kompania, si një ofrues sigurimesh, synon të zbatojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 dhe, për këtë arsye, të vazhdojë të zbatojë SNK 39 për pasuritë dhe detyrimet e saj financiare në periudhat e saj të raportimit duke filluar nga 1 Janari 2021.

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare nga Kompania, përveç nëse është shprehur ndryshe.

(a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale në kursin e këmbimit në datën e raportimit. Pasuritë dhe detyrimet jo monetare që maten me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me normën e këmbimit në datën në të cilën përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj përkthehen në kursin e këmbimit të çastit në datën e transaksionit. Diferenca në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi përgjithësisht njihen në fitim ose humbje.

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Kontrata nën të cilat Kompania pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të ardhshme të mundshme në një ose më shumë norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese, indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiare kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

(c) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit

(i) Primet e sigurimit jetësor

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumën e detyruar gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma i përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhe kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatimet mbi prime. Pjesa e fituar e primeve të arkëtuar njihet si e ardhur. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar. Primet e risigurimit njihen si shpenzim në përputhje me modelin e shërbimit të marrë të risigurimit.

(ii) Rezerva e primit të pafituar

Rezerva për primin e pafituar të jetës me afat dhe sigurimit personal është llogaritur nëpërmjet metodave aktuariale duke marrë në konsideratë vlerën e pamaturuar të policës së sigurimit të rregulluar me koeficientin e rrezikut të vdekshmërisë, për rrezikun e humbjes së jetës. Kompania ka përdorur metodën pro-rata (metodën 1/365) për të përcaktuar primin e pafituar. Primi i pafituar për sigurimin e mbrojtjes së pagesave ("PPI") është llogaritur bruto nga shpenzimet e marrjes në sigurim. Efekti i kostos së marrjes në sigurim është vlerësuar bazuar në normën e shpenzimeve të marrjes në sigurim ndaj primit të shkruar bruto.

(iii) Dëmet

Përfitimet e ndodhura për sigurimin e jetës gjatë aktivitetit të përgjithshëm përbëhen nga dëmet e paguara gjatë vitit financiar bashkë me ndryshimin në rezervën për dëmet pezull. Rikuperimet në avancë nga risigurimi paraqiten më vete si aktive. Rikuperimet nga risigurimi dhe rikuperime të tjera vlerësohen në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve pezull.

(iv) Rezerva për dëmet

Rezerva përfaqëson vlerësimin e kostos përfundimtare të shlyerjes së të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të shlyerjes së dëmit, të cilat lindin nga ngjarje që kanë ndodhur deri në datën e raportimit, dukë përfshirë një llogaritje të kostos së dëmeve të ndodhura por të pa raportuara (IBNR) në atë datë. Provizionimi për rezervat për dëmet pezull krijohet rast pas rasti në bazë të shumës së pritshme. Provizionimi për rezervat për dëmet e ndodhura por të pa raportuara krijohet përmes metodës të thjeshtëzuar të koeficientit të dëmeve.

(v) Deme që lindin nga veprimtaria e sigurimit të jetës

Demet e biznesit për sigurimin e jetës pasqyrojnë koston e të gjitha dëmeve që dalin gjatë vitit, duke përfshirë shpërblimet e policave të akorduara në pritje të një deklaratë bonusi

(vi) Rezerva të tjera matematikore

Rezerva për sigurimin e jetës llogaritet mbi një bazë të policave të sigurimit, duke përdorur formulën standarde aktuariale të faktorit të komutimit, bazuar në rezervën neto. Supozimet mbi vdekshmërinë dhe normën e interesit të përdorur në percaktimin e rezerves, janë në përputhje me supozimet e çmimeve.

(vii) Risigurimi

Kontratat që transferojnë një pjesë kryesore të rrezikut të sigurimit janë kontabilizuar si risigurime. Shumat e rikuperueshme nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit si dhe dëmet e lidhura. Pasuritë e risigurimit përfshijnë balancat për t'u arkëtuar nga Kompanitë e risigurimit për detyrimet nga sigurimet e ceduara. Shumat e

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit

rikuperueshme nga risiguruesit llogariten në të njëjtën mënyrë si janë llogaritur rezervat e dëmeve pezull, ose përbëjnë pjesën e papaguar nga risiguruesi të dëmeve të paguara nga Kompania që lidhen me policën e risiguruar. Kompania cedon primet e sigurimit dhe rrezikun për të limituar humbjet e mundshme lindur nga ekspozimi në rreziqe të konsiderueshme nga sigurimi i jetës.

Risigurimi nuk e liron siguruesin fillestar nga detyrimet e tij. Primet e ceduara paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën e ngarkuar gjatë vitit. Shumat e rimbursuara janë paraqitur në pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe në pasqyrën e pozicionit financiar në bazë bruto. Portofoli i produkteve është mbuluar nga një kontratë risigurimi e detyrueshme që mbulon pjesën mbi shumën maksimale të rrezikut lidhur me policat e sigurimit. Çdo përfitim shtesë, ndahet midis shumës së mbajtur dhe tejkalimit në të njëjtin proporcion si shuma e siguar dhe jetës. Pjesa e rezervës së risigurimit përcaktohet rast pas rasti në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

(viii) Shpenzimet e shtyra të përvetësimit

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të policave të sigurimit të jetës me kursim, afateve të rregullta dhe afateve të veçanta. Për policat Jeta me Afat, shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të komisionit të përcaktuar në baza individuale të policave. Komisioni i paguar për çdo policë është i ndarë nga shuma e shkruar e asaj police. Raporti që rezulton është shumëfishuar me rezervat e primit te pafiturar të primeve bruto të shkruara. Si rezultat, shpenzimet e marrjes shtyhen për kohëzgjatjen e policave përkatëse. Për policat e sigurimit me kursim, shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë llogaritur në përputhje me Standardet e kostove të shtyra të marrjes në sigurim të Uniqa Group. Kompania ka zbatuar qasjen e thjeshtuar të specifikuar në standard. Kështu që për llogaritje është përdorur skedari i thjeshtuar i standardeve i ofruar nga Grupi, së bashku me supozimet e mëposhtme:

- Normat e zbritjes - Normat e liruara nga rreziku që llogariten dhe merren nga Grupi
- Normat e ndalimit - normat e llogaritura në bazë të përvojës së portofolit
- Shkalla e vdekshmërisë - vdekshmëria nga TM-ja e përshtatur për mbajtësin e policës mesatare për secilin vit të nënshkrimit
- Komisioni - komisionet aktuale të brokerimit.

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si shpenzime që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit, si dhe shpenzimet administrative të ndara lidhur me përpunimin e propozimeve dhe lëshimin e policave.

(d) Instrumentet financiare

Pasuritë financiare

Njohja dhe matja fillestare e pasurive financiare

Ndërsa pasuritë financiare klasifikohen në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke përfshirë derivativët, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, të mbajtura deri në maturim, pasuritë financiare të vlefshme për shitje. Kompania përcakton klasifikimin e pasurive të saj financiare në njohjen fillestare.

Pasuritë financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e investimeve jo me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt.

Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë blerë ose janë krijuar investimet. Pasuritë financiare klasifikohen si në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, kur strategjia e dokumentuar e investimeve e Kompanisë është që të menaxhojë investimet financiare mbi një bazë të vlerës së drejtë, sepse detyrimet përkatëse menaxhohen gjithashtu mbi këtë bazë.

Kompania klasifikon pasuritë financiare në kredi dhe të arkëtueshme dhe pasuritë e mbajtura deri në maturim dhe detyrimet financiare jo derivate në detyrime të tjera financiare.

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Instrumentet financiare (vazhdim)

Matja pasuese

Matja pasuese e pasurive financiare varet nga klasifikimi i tyre si më poshtë:

- Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Investimet e blera zakonisht me qëllimin për tu shitur në të ardhmen e afërt klasifikohen si të mbajtura për tregtim dhe ato maten me vlerën e drejtë përmes llogarisë së fitimit ose humbjes. Kompania nuk ka investime të klasifikuara si pasuri financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019.

- Asetet financiare të mbajtura deri në maturim

Pasuritë financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturitet fiks klasifikohen si të mbajtura deri në maturim kur Kompania ka qëllimin dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim. Pas matjes fillestare, pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim maten me koston e amortizuar, duke përdorur NEI, më pak rënie në vlerë. Rënia në vlerë NEI përfshihet në "të ardhurat nga investimet" në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur investimet çregjistrohen ose bien në vlerë, si dhe përmes procesit të amortizimit. Kompania klasifikon obligacionet qeveritare si të mbajtura deri në maturimin e pasurisë financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

- Pasuritë financiare të disponueshme për shitje

Të gjitha investimet të cilat nuk janë klasifikuar si pasuri financiare të mbajtura për tregtim ose mbajtje deri në maturim ose hua dhe të arkëtueshme, ato klasifikohen si pasuri financiare të disponueshme për shitje. Pas njohjes fillestare, pasuritë financiare të disponueshme për shitje ri-maten me vlerën e drejtë, përveç nëse vlera e drejtë nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme maten me koston minus çdo zvogëlim të humbjes nga rënia në vlerë. Vlerat e drejta bazohen në çmimet e kuotuar ose vlerësohen bazuar në modelet dhe raportet e rrjedhës së parasë që pasqyrojnë rrethanat specifike të emetuesit. Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të disponueshëm për shitje njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Kur pasuria çregjistrohet, ose konsiderohet të zhvlerësohet, fitimi ose humbja e akumuluar riklasifikohet nga "Rezerva e rivlerësimit të pasurive financiare të disponueshme për shitje" në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe hiqet nga rezerva e rivlerësimit të pasurive financiare të disponueshme për shitje.

Kompania nuk mban investime të klasifikuara si pasuri financiare të disponueshme për shitje më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019.

- Kreditë dhe të arkëtueshme të tjera

Huatë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Të gjitha kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes përfshihen gjithashtu në koston e investimit. Pas matjes fillestare, huatë dhe të arkëtueshmet maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e normës efektive të interesit (NEI), më pak provizione për zhvlerësim. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose premium të blerjes dhe tarifës ose kostove që janë pjesë integrale e NEI. Amortizimi i NEI përfshihet në "të ardhurat nga investimet" në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur investimet çregjistrohen ose zhvlerësohen, si dhe përmes procesit të amortizimit.

Çregjistrimi i pasurive financiare

Kompania çregjistron një pasuri financiare kur:

- skadojnë të drejtat kontraktuale të rrjedhjeve të parasë, ose
- transferon të drejtat për të marrë rrjedhjet kontraktuale të parave të gatshme në një transaksion në të cilin transferohen në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare, ose as nuk i transferon, as i ruan në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë dhe mbajnë kontrollin mbi pasurinë e transferuar.

Detyrimet financiare

Njohja dhe matja fillestare

Detyrimet e tjera financiare jo derivative fillimisht maten me vlerën e drejtë minus çdo kosto të transaksionit që i atribuohet drejtpërdrejt.

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Instrumentet financiare (vazhdim)

Matja pasuese

Pas njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çregjistrimi i detyrimeve financiare

Kompania çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen ose anulohen, ose skadojnë.

Netimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Kompania ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të arkëtojë ose të mbyll pasurinë apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga standardet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Kompanisë.

Matja me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një pasuri mund të këmbehet ose një detyrim mund të paguhet midis palëve që kanë njohurinë dhe mundësinë të kryejnë transaksione në marrëdhënie normale tregu në datën e matjes. Kur është e mundshme, Kompania e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur cmimet e kuotuar për këtë instrument në tregje aktive. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Kompania përdor teknikat e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në çmimet e një transaksion. Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit perkatesisht vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Kompania konstaton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose transaksioni mbyllet.

Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi, Kompania vlerëson nëse ka dëshmi objektive që pasuritë financiare që nuk mbarten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë të zhvlerësuara. Pasuritë financiare janë të zhvlerësuara kur dëshmitë objektive tregojnë se një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në flukset monetare të ardhshme të aktivitetit që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Evidenca objektive që një aktiv financiar është zhvlerësuar mund të përfshijë mos-pagesen ose delinkuencen e huamarrësit, ristrukturimin e kredisë ose paradhënies nga Kompania me kushte që, në rrethana të tjera, nuk do të kishte konsideruar, tregues se një huamarrës ose emëtues do të futet në probleme likuiditeti, ose të dhëna të tjera të monitorueshme lidhur me një grup aktivesh sikurse lëvizjet e pafavorshme në statusin e pagesave të huamarrësit për Kompaninë, ose kushte ekonomike që janë në korrelacion me mos-pagesen në grup.

Kompania merr parasysh dëshmi të zhvlerësimit në nivele kolektive dhe specifike. Kreditë në nivel kolektiv vlerësohen për zhvlerësim duke grupuar së bashku huamarrësit me karakteristika të ngjashme të kredisë.

Kreditë në nivel specifik identifikohen në bazë të dëshmitë objektive të një niveli rreziku që tejkalon nivelin historik të rrezikut të kredive të tilla si mungesa, ristrukturimi, kushtet e përkeqësuar ekonomike dhe delikuencës së më shumë se 90 ditëve për një huamarrës të vetëm që nuk ka të ardhura të evidentuara. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi kthehet në fitim ose humbje.

(e) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në thirrje me Kompaniat dhe investime të tjera shumë të likuide afatshkurtra me maturim fillestar prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që i nënshtrohen një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe janë përdorur nga Kompania në menaxhimin e saj angazhime afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)***4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)****(f) Depozitat me afat**

Depozitat me afat janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit të mbetur dhe klasifikohen si ato me maturim fillestar më shumë se tre muaj. Interesi është përlogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe interesat e arkëtueshme pasqyrohen në të arkëtueshmet e tjera.

(g) Investimi në letra me vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Kompania ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim dhe si rrjedhim maten me kosto të amortizuara, minus provizionin për rënien në vlerë. Kosto e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje.

(h) Sigurimet dhe të arkëtueshmet tjera

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë llogaritë e arkëtueshme nga të siguruarit dhe njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar minus humbjet nga rënia në vlerë.

(i) Sigurimet dhe të pagueshmet tjera

Llogaritë e pagueshme nga sigurimi dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e transaksioneve të lidhura drejtpërdrejtë me të. Këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(j) Pajisjet*(i) Njohja dhe matja*

Zërat e pajisjeve maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejtë të atribueshme për blerjen e pajisjes. Kostoja e pasurive të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitetit në punë si edhe kostot çmontimit e rikthimit të vendit në të cilin ato do të vendosen, në gjendjen e tij fillestare. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kapitalizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë ndarë (përbërës kryesorë) të pajisjeve.

(ii) Kostot e mëvonshme

Kostoja e zëvendësimit të një elementi të pajisjeve i shtohet vlerës kontabël të këtij elementi nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhen me këtë element do të shkojnë për Kompaninë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e mirëmbajtjes ditore të pajisjeve njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në momentin kur ato ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi dhe amortizimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes duke përdorur metodën e llogaritjes mbi vlerën e mbetur. Pasuritë e marra me qira zhvlerësohen për perudhën më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk zhvlerësohet. Normat e zhvlerësimit për periudhat aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

	%
Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme	4 vite
Mobilje, instalime dhe pajisje	5 vite

Metodat e amortizimit dhe jeta e dobishme rivlerësohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, në çdo datë raportimi.

(k) Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme njihen nëse vlerësohet se përfitimet e ardhshme ekonomike që i atribuohen asetit do të hyjnë në Kompani dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri. Asetet e paprekshme fillimisht maten si kosto. Vlerat kontabël të pasurive jo-materiale vlerësohen për një rënie të vlerës, kur ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera kontabël nuk mund të rikuperohet. Asetet e paprekshme përbëhen tërësisht nga programet kompjuterikë që zhvlerësohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të vlerësuar.

Asetet e paprekshme kanë jetë të dobishme të përcaktuar prej 3 vjetësh dhe amortizohen gjatë këtij afati.

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(I) Prona dhe paisjet e marra me qira

SNRF 16 i zbatueshëm për periudhat e raportimit pas datës 01 janar 2019 specifikon se si një entitet që raporton, do të njohë, matë, prezantojë dhe shpalos qirat. Standardi siguron një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit, duke kërkuar nga qiramarrësit të njohin asetet dhe detyrimet për të gjitha qiradhëniet, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave me vlerë të ulët. Kompania ka aplikuar SNRF 16 duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive dhe për rrjedhojë, informacioni krahasues nuk është përshtatur dhe vazhdon të raportohet sipas SNK 17 dhe KIRFN 4. Në këtë datë, Kompania ka zgjedhur gjithashtu të matë pasuritë e përdorimit të duhur në një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë të rregulluar për çdo pagesë të parapaguar ose të llogaritur të qirasë që ka ekzistuar në datën e tranzicionit.

Detajet e politikave të kontabilitetit sipas SNK 17 dhe KIRFN 4 janë shpalosur veçmas nëse ato janë të ndryshme nga ato nën SNRF 16 dhe ndikimi i ndryshimeve shpaloset në Shënimin 15 .

Kompania njeh një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim të qirasë në datën e fillimit të qirasë. Pasuria me të drejtë përdorimi fillimisht matet me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte të ndodhur dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe heqjen e aktivin themelor ose për të rivendosur aktivin themelor ose sitin në të cilin është vendosur, më pak çfarëdo stimul të marrë me qira të marra.

Pasuria me të drejtë përdorimi zhvlerësohet më pas duke përdorur metodën e linjës së drejtpërdrejtë nga data e fillimit deri në fillim të fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit ose përfundimit të afatit të qirasë.

Jeta e vlefshme e dobishme e pasurive me të drejtë përdorimi përcaktohet në të njëjtën bazë si ato të pasurive dhe pajisjeve. Për më tepër, pasuria me të drejtë përdorimi zvogëlohet në mënyrë periodike nga humbjet e zhvlerësimit, nëse ka, dhe rregullohet për rimarrje të caktuara të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën e tanishme të pagesave të qirasë, të cilat nuk paguhen në datën e fillimit, duke u zbritur duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, shkalla e huazimit në rritje të Kompanisë. Në përgjithësi, Kompania përdor normën e saj të huamarrjes në rritje si norma e skontimit.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë si më poshtë:

- pagesa fikse, përfshirë pagesa fikse në substancë;
- pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose kursin në datën e fillimit;
- shumat që pritet të paguhen nën një garanci të vlerës së mbetur; dhe
- cmimi i ushtrimit nën një mundësi blerjeje që Kompania është me siguri të arsyeshme për të ushtruar, qiratë e qirave në një periudhë rinovimi opsionale nëse Kompania është me siguri të arsyeshme të ushtrorë një mundësi shtesë, dhe gjobitje për përfundimin e parakohshëm të një qiraje, përveç nëse Kompania është e sigurtë të mos e përfundojë me herët.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e qirasë në të ardhmen që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Bankës për shumën që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur, ose nëse Kompania ndryshon vlerësimi nëse do të ushtrorë një mundësi blerjeje, zgjatjeje ose përfundimi.

Kur detyrimi i qirasë është rivlerësuar në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël të aktivit të së drejtës së përdorimit, ose regjistrohët në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e aktivit të së drejtës së përdorimit është zvogëluar në zero.

Kompania paraqet pasuritë me të drejtë përdorimi, të cilat nuk plotësojnë përkufizimin e pasurisë së investimit në "pronë, fabrikë dhe pajisje "dhe detyrimet e qirasë në" detyrime të tjera "në pasqyrën e pozicionit financiar (shënim 15).

Në kalimin në SNRF 16, niveli mesatar i ponderuar i huamarrjes në rritje i aplikuar për detyrimet e qirasë të njohura sipas SNRF 16 ishte 4.86% .

Kompania përdor një ose më shumë nga përdoruesit praktikë të mëposhtëm sipas SNRF 16.C10, duke e aplikuar atë në bazë të qirasë:

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(I) Prona dhe paisjet e marra me qira (vazhdim)

- Përdorimi i një norme të vetme zbritje në një portofol të qirave me karakteristika të ngjashme;
- Rregullimi i pasurisë me të drejtë përdorimi për çdo provizion të njohur të qirasë, në vend të kryerjes së rishikimit të zhvlerësimit;
- Aplikimi i një lirimi nga njohja për qiratë për të cilat afati i qirasë përfundon brenda 12 muajve nga data e aplikimit fillestar dhe qiratë e pasurive me vlerë të ulët (Për këtë qëllim Kompania ka zgjedhur një prag prej rreth 5 mijë €). Kompania njeh pagesat e qirasë që lidhen me këto qira si një shpenzim në bazë lineare për periudhën e qirasë;
- Duke përjashtuar kostot fillestare direkte nga matja e pasurisë me të drejtë përdorimi;
- Përdorimi i mbikëqyrjes, siç është përcaktimi i afatit të qirasë nëse kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose ndërprerjen e qirasë.

Në fillimin e një kontrate, Kompania vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të vlerësimit. Për të vlerësuar nëse një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar, Kompania vlerëson nëse:

- kontrata përfshin përdorimin e një pasurie të identifikuar - kjo mund të specifikohet në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar, dhe duhet të jetë e veçantë fizikisht ose të përfaqësojë në thelb të gjithë aftësinë e një aktivi fizikisht të veçantë. Nëse furnizuesi ka një të drejtë substanciale zëvendësimi, atëherë aktivi nuk identifikohet;
- Kompania ka të drejtë të marrë në mënyrë thelbësore të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivit gjatë gjithë periudhës së përdorimit; dhe
- Kompania ka të drejtë të drejtojë përdorimin e aktivit. Kompania ka këtë të drejtë kur ka të drejtat e vendimmarrjes që janë më të rëndësishme për të ndryshuar sesi dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi. Në raste të rralla kur vendimi se si dhe për çfarë qëllimi aktivi është përdorur i paracaktuar, Kompania ka të drejtë të drejtojë përdorimin e aktivit nëse:
- Kompania ka të drejtë të drejtojë aktivin; ose
- Kompania projektoi aktivin në një mënyrë që paracakton se si dhe për çfarë qëllimi do të përdoret.

Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura ose ndryshuar, në ose pas 1 janarit 2019.

Në fillimin ose në rivlerësimin e një kontrate që përmban një komponent të qirasë, Kompania i akordon vlerësimet në kontratë secilit komponent të qirasë në bazë të çmimeve të tyre individuale. Sidoqoftë, për qiradhëniet e tokës dhe ndërtesave në të cilat është qiramarrës, Kompania ka zgjedhur të mos ndajë komponentët e qirasë dhe të mos llogarisë komponentët e qirasë dhe të qirasë si një komponent të vetëm të qirasë.

Zhvlerësimi i pasurive jo-financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të Kompanisë, përveç pasurive tatimore të shtyra, shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, vlera e rikuperueshme vlerësohet. Një humbje nga rënia në vlerë njihet kurdoherë që vlera që mban një pasuri ose njësi e tij e gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Njësi gjeneruese e mjeteve monetare është njësi më e vogël e identifikueshme e grupimit të pasurive që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Vlera e rikuperueshme e një pasuri ose një njësie gjeneruese, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës reale pasi janë zbritur kostot e shitjes. Në përlllogaritjen e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme aktualizohen duke përdorur një normë të rregulluar për efektin e taksës e cila reflekton vlerësimet e tregut për vlerën në kohë të parasë si edhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbja nga rënja e vlerës të njohura nga periudha e mëparshme financiare, rishikohet në çdo vit për të vlerësuar nëse ka tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga rënja në vlerë rimerret nëse ka patur ndonjë ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Humbja nga rënja në vlerë kthehet vetëm në masën, me të cilën vlera që aktivi mban, nuk tejkalon vlerën e mbetur të tij e cila do ishte përcaktuar si vlera neto pas zhvlerësimit nëse nuk do ishte njohur humbja nga rënja në vlerë.

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(l) Njohja e të ardhurave

Politikat kontabël për njohjen e të ardhurave nga kontratat e sigurimit janë paraqitur në notën 5.c.i. Të ardhurat nga interesi për pasuritë financiare janë njohur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(m) Përfitimit e punonjësve

Kompania paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni kur këta të fundit dalin në pension. Qeveria është përgjegjëse për sigurimin e kufirit minimal ligjor për pensionet në Kosovë sipas një plani pensional me kontribute të përcaktuara. Kontributet e Kompanisë në planin e pensionit ngarkohen në pasqyrën e fitimit dhe humbjes kur ato ndodhin dhe Kompania nuk detyrime të tjera.

(n) Qiratë operative

Qiratë në të cilat një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë lineare për të gjithë periudhën e qirasë. Kur një qira operative përfundon para afatit të qirasë paracaktuar, çdo pagesë që kërkohet t'i bëhet qiradhënësit me anë të ndëshkimit, njihet si një shpenzim në periudhën në të cilën ndërprerja ndodh.

(o) Provizionet

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i një ngjarjeje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin.

Nëse këto kushte nuk plotësohen, nuk ka asnjë provizion të njohur në pasqyrat financiare. Provizionet nuk njihen për humbjet e ardhshme të funksionimit. Provizionet rishikohen në secilin fund të periudhës dhe rregullohen për të pasqyruar vlerësimin aktual më të përshtatshëm. Diferencat që rezultojnë nga rregullimet e nevojshme njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes për periudhën. Provizionet përcaktohen duke zbritur rrjedhjet e pritshme të parave të gatshme në normën para tatimit. Dispozitat pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parave dhe, kur është e përshtatshme, rreziqet specifike për pasivin. Rritja e provizionit për shkak të kalimit të kohës njihet si një shpenzim interesi.

(p) Tatimi aktual në të ardhura dhe tatimi i shtyrë

Tatimi aktuale mbi të ardhurat është në fuqi nga 5 gusht 2019 dhe vazhdon gjithashtu në vitin 2020. Në pasqyrat financiare ajo paraqitet pas fitimit neto para taksave. Në këtë llogaritje përfshihen: PFB, rezervat dhe pretendimet që pranohen të njihen si shpenzime nga rezervat dhe pretendimet e bëra nga momenti i ndryshimeve në ligj dhe jo për kontratat e shitura para datës 5 gusht 2019. Gjithashtu një pjesë e kësaj llogaritje përjashtohen dhe jo përveç shpenzimeve dhe të ardhurave nga interesi.

(q) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si ekuitet. Kostot e rritjes që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të zakonshme njihen si zbritje nga kapitali neto, pa ndonjë efekt tatimor.

Dividenda

Dividentët në aksionet e zakonshme njihen si një detyrim në periudhën në të cilën ato deklarohen.

(r) Detyrimet ose pasuritë kontigjente

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime, përveç nëse mundësia e një rrjedhje burimesh që mishërojnë përfitime ekonomike është shumë e vogël. Një pasuri kontigjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por paraqitet në shënime kur një fluks i përfitimeve ekonomike është i mundshëm.

(s) Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Ngjarjet pas periudhës së raportimit janë ato ngjarje, të favorshme dhe të pafavorshme, që ndodhin ndërmjet datës së bilancit dhe datës së pasqyrave financiare që janë autorizuar për lëshim. Ngjarjet pas periudhës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e Kompanisë në datën e bilancit të gjendjes janë ngjarje të mëvonshme që çojnë në rregullime të pasqyrave financiare.

Ngjarjet pas periudhës raportuese që japin indikacione mbi kushtet e lindura pas datës së bilancit të gjendjes, nuk çojnë në rregullimin e pasqyrave financiare, por do të zbulojnë natyrën e ngjarjes jo-rregulluese dhe një vlerësim të efektit të saj financiar, ose një deklarata se një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet, nëse është e zbatueshme.

5. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlydhura bazohen në përvojën historike dhe faktorët e ndryshëm që besohet të jenë të arsyeshëm në rrethanat dhe informacionet e disponueshme në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare, rezultatet e të cilave formojnë bazën për të bërë gjykime mbi vlerat që mbajnë pasuritë dhe detyrimet që nuk janë të dukshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse ndryshimi ndikon në periudhat aktuale dhe në të ardhmen.

Gjykimet e bëra nga drejtimi në zbatimin e SNRF-ve që kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare dhe vlerësimet me një rrezik të konsiderueshëm të përshtatjes materiale në vitin e ardhshëm janë shpalosur më poshtë.

Vlerësimi përfundimtar që lind nga dëmet sipas kontratave të sigurimit

Vlerësimi i detyrimit përfundimtar që rrjedh nga dëmet sipas kontratave të sigurimit është vlerësimi kontabël më i rëndësishëm i Kompanisë. Në këtë vlerësim duhet të përfshihen disa burime të rëndësishme të pasigurisë për vlerësimin e detyrimit përfundimtar të Kompanisë për këto dëme. Përcaktimi i detyrimeve sipas kontratave afatgjata të sigurimit varet nga vlerësimet e bëra nga Kompania. Vlerësimet bëhen duke marrë parasysh pritshmëritë për numrin e vdekjeve për çdo vit në të cilin Kompania është e ekspozuar ndaj rrezikut. Kompania i bën këto vlerësime bazuar tek tabelat e personalizuar të vdekshmërisë të rajonit për shkak të mungesave të të dhënave të besueshme në Kosovë të cilat përshtaten për të reflektuar përvojën e vetë Kompanisë. Për kontratat të cilat sigurojnë rrezikun e jetëgjatësisë, krijohet një pritshmëri e kujdeshme por jo e tepruar për përmirësimet në lidhje me vdekshmërinë. Burimi kryesor i pasigurisë është që epidemitë (psh. SIDA, SARS dhe ndryshime të rëndësishme të stilit të jetesës, të tilla si ushqimi, pirja e duhanit, programet e ushtrimit, traumat e pasluftës mund të rezultojnë në pritshmëritë e vdekshmërisë të qenit në mënyrë të rëndësishme më keq se në të shkuarën për grup moshë ndaj të cilave Kompania është e ekspozuar në mënyrë të rëndësishme ndaj rrezikut të vdekjes). Megjithatë, përmirësimet e vazhdueshme në kujdesin mjekësor dhe kushtet sociale mund të rezultojnë në përmirësime të jetëgjatësisë përtej atyre të marra parasysh në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e detyrimeve që lindin nga kontratat kur Kompania është e ekspozuar ndaj rrezikut të jetëgjatësisë. Në çdo datë raportimi, Kompania kryen analiza për t'u siguruar mbi mjaftueshmërinë e rezervave për kontratat e sigurimit. Testet kryesore lidhen me analizat e raportit të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit mbi linjat kryesore të aktivitetit në mënyrë individuale (sigurimi i jetës për hua dhe sigurimi i kombinuar). Llogaritja kryhet vetëm mbi dëmet si dhe mbi dëmet duke përfshirë shpenzimet e marrjes në sigurim dhe shpenzime të tjera të trajtimit. Gjatë kryerjes së kësaj analize, Kompania merr parasysh vlerësimet aktuale të flukseve dalëse të parasë. Kompania nuk i skonton këto flukse dalëse sepse pjesa më e madhe e dëmeve pritet të paguhen brenda një viti. Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë për supozimet kryesore të përdorura për vlerësimin e detyrimeve nga dëmet paraqitet në shënimin 6.6.

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit

Kompania është e ekspozuar ndaj rrezikut aktuarial dhe marrjes në sigurim që rrjedhin nga një gamë e gjerë e produkteve të jetës të ofruara për konsumatorët.

Rreziku i sigurimit ka të bëjë me pasigurinë e biznesit të sigurimit. Komponentët më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Kjo ka të bëjë me shqetësimin në lidhje me përshtatshmërinë e nivelit të normës së primit të sigurimit dhe mjaftueshmërinë e rezervave për detyrimet e sigurimit dhe baza e kapitalit.

Rreziku i primit është i pranishëm sapo është lëshuar polica e sigurimit, dhe është rreziku që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara të jenë më të larta se primi i marrë. Rreziku rezervës paraqet rrezikun që niveli absolut i rezervave teknike është i nënvlerësuar ose që pretendimet faktike do të luhaten rreth vlerës statistikore të përlogaritur.

Komponentët e rrezikut të marrjes në sigurim të biznesit të jetës përfshijnë edhe rrezikun biometrik (duke përfshirë vdekshmërinë, jetëgjatësinë, sëmundshmërinë dhe paaftësinë) dhe rrezikun e gabimit. Rreziku i gabimit lidhet me normën më të lartë të paparashikuar ose normën më të ulët të gabimeve të policave, anulimeve, ndryshimet në statusin e pagesës (ndërprerjen e pagesës së primit) dhe të ndërprerjeve

6.1 Objektivat e menaxhimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit

Rreziku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe prej pasigurisë rreth shumës së dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky rrezik është i rastësishëm dhe i paparashikueshëm. Kompania e pranon rrezikun nga sigurimi nëpërmjet kontratave të sigurimit dhe disa kontratave të investimeve ku ajo mbart rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë të lidhura direkt me humbjen. Kompania është e ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata.

Risigurimi blihet nga Kompania për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risiguroes të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrëveshjeve për humbjen. Kapitali rregullator menaxhohet (por jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Kompania është e ekspozuar. Për një portofol të kontratave të sigurimit ku teoria e probabilitetit është aplikuar për vendosjen e çmimit dhe rezervën, rreziku kryesor që Kompania ka nga kontratat e saj të sigurimit është se dëmet aktuale dhe pagesat e përfituesit janë më të mëdha se vlera e mbartur e detyrimeve të sigurimit. Kjo mund të lindë sepse frekuenca ose ashpërsia e dëmit dhe përfitimit janë më të mëdha se llogaritja. Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperienca tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

6.2 Strategjia e marrjes në sigurim

Kompania ka zhvilluar strategjinë e saj të marrjes në sigurim duke diversifikuar llojin e rreziqeve të cilat ajo pranon dhe brënda secilës kategori të arrijë një popullatë rreziku relativisht të madhe për të ulur luhatjet e rezultateve të pritshme.

6.3 Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit

Përgjithësisht, të gjitha produktet e Kompanisë mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë, në disa raste mbulimi kufizohet në mbulim të pjesshem, të humbjeve si pasojë e aksidenteve. Produktet e tjera përveç jetës me kursim kanë karakteristika të njëjta të produkteve me afat të shkurtër dhe janë të rinovueshme çdo vit me opsionin e ndryshimit të primit nga ana e Kompanisë. Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit të cilat kanë një efekt material mbi vlerën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë janë paraqitur më poshtë.

Sigurimi i jetës për hua

Kontratat e klasifikuara si "Sigurimi i Jetës për hua" janë përgjithësisht polica vjetore të rinovueshme që mbulojnë rrezikun e vdekjes dhe ofrohen për bankat së bashku me kredinë. Shuma e siguruar zvogëlohet paralelisht me ripagimin e kredisë.

Sigurimi i kombinuar

Sigurimi i kombinuar përbëhet nga polica përmes të cilave Kompania shkruam prime të jetes me afat dhe sigurimit shendetesor. Kontratat e jetës me afat shlyejnë përfitimet e garantuara në rast vdekjeje të cilat janë të përcaktuara në shumën e sigurimit fikse që nuk varen nga Kompania. Kontratat lëshohen për individë dhe grupe individësh.

*(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)***6. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)****6.3 Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit (vazhdim)***Jeta me kursim*

“Jeta me kursim” përfshin sigurimin e jetës dhe gjithashtu përfshin edhe një komponent kursimi. Përfitimet nga ky produkt i merr i siguruari nëse ai/ajo jeton në datën e maturimit të policës ose trashëgimtarët në rast të kundërt. Data e maturimit varion nga 5 deri 30 vjet. Në rast të daljes nga siguri gjatë tre viteve të parë të policës, Kompania nuk ka asnjë detyrim ndaj policëmbajtësit. Pas kësaj periudhe, Kompania paguan vlerat e përcaktuara nga kushtet në policë. Produkti është afatgjatë dhe me përfitime të garantuara, madhësia e të cilave pritet të rritet në të ardhmen. Përfitimi në rast vdekje është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin dhe shumën e siguruar e cila varion nga 2,400 Euro deri në 50,000 Euro.

Risigurimi dhe përqëndrimi i rrezikut

Risigurimi përdoret për të menaxhuar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjësinë e Kompanisë si siguruesi kryesor. Nëse risiguruesi nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Kompania është e detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin. Aftësia paguese e risiguruesit analizohet çdo vit duke rishikuar pozicionin e tyre financiar përpara së të nënshkruajnë kontratën. Kompania ka ceduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin nga humbjet nga kontratat e nënshkurara dhe të minimizojë efektin e humbjes nga siguri i jetës, duke nënshkruar kontrata risigurimi.

6.4 Ekspozimi që lidhet me ngjarjet katastrofike

Kompania konsideron se gjatë aktivitetit të saj të sigurimit ajo nuk ka akumuluar ekspozime të rëndësishme ndaj ngjarjeve katastrofike.

6.5 Interesi teknik

Norma e interesit teknik përdoret kur llogaritet rezerva. Norma e interesit teknik është kthimi minimal i garantuar për çdo kontratë të sigurimit të jetës. Për të shmangur rrezikun që të ardhurat nga investimet nuk do të mbulojnë kthimin minimal të garantuar, Kompania ka përdorur një normë interesi prej 2.38% në llogaritjen e rezervave matematikore. Në vitin 2020, të ardhurat neto të gjeneruara nga investimet (duke përfshirë rezervat matematikore) mbulojnë të ardhurat minimale të garantuara për një pjesë të portofolit, duke dhënë fitim shtesë mbi interesin teknik. Analiza e parametrave aktuarialë të përdorur në llogaritjen e tarifave dhe rezervave të sigurimit të jetës tregon se supozimet janë të përshtatshme.

6.6 Rezervat dhe supozimet aktuariale

Kompania llogarit dhe ngarkon rezervat e sigurimit për jetën (rezervat matematikore) për të paraqitur pagesat e ardhshme nën policat e sigurimit me afat të gjatë. Shumë faktorë ndikojnë llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anulimet dhe interesin teknik. Rezerva për sigurimin e jetës është llogaritur në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë.

Kompania llogarit dhe ngarkon rezerve teknike për të siguruar pagesat e ardhshme sipas politikave afatgjata të sigurimit. Shumë faktorë ndikojnë në llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anulimet dhe interesin teknik. Rezerva teknike llogaritet në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve është i kufizuar në analizën e parametrave kryesorë që kanë ndikimin më të rëndësishëm në llogaritjen e rezervës. “Vdekshmëria” është rreziku që mbulohet nga të gjithë produktet e sigurimit që Kompania ka.

Të dhënat lidhur me “vdekshmërinë” për vitin 2020 dhe 2019 duke përfshirë vlerësimet e përdorura janë si më poshtë:

	2020	2019
Numri i personave të siguruar të prekshëm nga rreziku i vdekjes	17,060	13,505
Mosha mesatare e personave të prekshëm nga rreziku i vdekjes	55	54
Numri i pagesave për të siguruarit që kanë vdekur	69	17

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

6.6 Rezervat dhe supozimet aktuariale (vazhdim)

Supozimet dhe ndjeshmeria

Faktorët kryesorë që ndikojnë në fitimin e Kompanisë janë raporti i nivelit të dëmeve dhe shpenzimeve. Tabela më poshtë paraqet një simulim, duke marrë në konsideratë ndryshimet për dëmet e ndodhura ose rritje në shpenzime dhe efektin e tyre në kapitalin neto të Kompanisë dhe aftësinë paguese në dispozicion. Për qëllime të simulimit, modeli përdor një rritje të dëmeve të barabartë me dëmin më të madh të ndodhura gjatë dy viteve të fundit dhe një rritje të shpenzimeve administrative prej 10%.

31 dhjetor 2020	Fitimi (Humbja)	Kapitali neto	Fondet e garancisë së detyrueshme
Aktual	41,760	4,675,388	3,200,000
Rritje në dëmet e ndodhura	(50,000)	4,625,388	3,200,000
Rritje në shpenzime (+10%)	(73,269)	4,552,119	3,200,000

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kualitative të ndjeshmërisë. Kompania përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë tregues të tillë si raporti i humbjes së pritur. Kompania e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për rezervën e dëmeve të sigurimit të jetës që njihet në pasqyrën e pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur. Një përmbledhje e humbjeve nga dëmet dhe raporti i kombinuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	2020	2019
Koeficienti i dëmeve	29.05%	24,94%
Koeficienti i shpenzimeve	70.27%	60,77%
Koeficienti i kombinuar	99.32%	85,70%

Rezultatet e analizës së sensitivitetit që tregojnë impaktin në fitim për vitin janë paraqitur më poshtë. Për këtë lloj sensitiviteti tregohet impakti i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara.

	Ndikimi	2020	2019
Koeficienti i dëmeve			
5% rritje në koeficientin e dëmeve	Humbje	(15,142)	(12,637)
5% zvogëlim në koeficientin e dëmeve	Fitim	15,142	12,637
Koeficienti i shpenzimeve			
5% rritje në koeficientin e shpenzimeve	Humbje	(36,634)	(30,795)
5% zvogëlim në koeficientin e shpenzimeve	Fitim	36,634	30,795
Koeficienti i kombinuar			
5% rritje në koeficientin e kombinuar	Humbje	(51,777)	(43,432)
5% zvogëlim në koeficientin e kombinuar	Fitim	51,777	43,432

6.7 Risigurimi

Kompania cedon rrezikun e sigurimit që të kufizojë ekspozimin e humbjeve duke lidhur marrëveshje të ndara për çdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi e shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Shuma e secilit rrezik të mbetur varet nga vlerësimi që Kompania i bën rreziqeve specifike, i cili është subjekt në disa rrethana, i limiteve maksimale bazuar në karakteristikat e mbulimit. Nën termat e marrëveshjes së risigurimit, risiguruesi bie dakort që të rimbursojë shumën e ceduar në rastin e dëmeve të paguara. Megjithatë, Kompania mbetet e detyruar ndaj policëmbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse risiguruesi nuk përmbush detyrimet e tij.

Përqendrimi i rezervave teknike dhe të dëmeve sipas llojit është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A**Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë në euro, përveç nëse shprehet ndryshe)***6. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)****6.7 Risigurimi (vazhdim)**

	2020			2019		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Lloji i rezervave						
RBNS	65,253	-	65,253	41,165	-	41,165
IBNR	6,525	-	6,525	4,117	-	4,117
Rezervat matematikore	387,262	-	387,262	410,187	-	410,187
Gjithsej	459,040	-	459,040	455,469	-	455,469

Përqendrimi i primit të pafitur sipas llojit të kontratës është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

	2020			2019		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Linja e biznesit						
Sigurimi jeta me afat	267,685	(8,118)	259,567	243,352	(7,489)	235,862
Sigurimi personal	8,004	(589)	7,415	12,900	(1)	12,899
Sigurimi jeta me kursim	728	-	728	1,007	-	1,007
Gjithsej	276,417	(8,706)	267,711	257,259	(7,490)	249,769

7. Menaxhimi i riskut financiar

Kompania monitoron dhe menaxhon risqet financiare që lidhen me operacionet e Kompanisë nëpërmjet analizës së riskut të brendshëm që përshkruan ekspozimet sipas shkallës dhe madhësisë së rreziqeve. Këto risqe përfshijnë riskun e tregut (riskun valutor, riskun e normës së interesit), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Kompania nuk përdor instrumente financiare derivative për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve.

(i) Risku i tregut

Risku i tregut mund të përshkruhet si risku i ndryshimit në vlerën e drejtë të një instrumenti financiar për shkak të ndryshimeve në normat e interesit, çmimet e kapitalit ose normat e këmbimit valutor. Është një risk i tregut minimal më 31 dhjetor 2020 dhe 2019. Kompania nuk investon në aksione dhe ka instrumente financiare pothuajse ekskluzivisht të shprehura në Euro. Risku i normës së interesit është kryesisht me investime të mbajtura deri në maturim që mbahen me norma fikse.

(ii) Risku valutor

Kompania kryen transaksione kryesisht në Euro për të përmbushur kërkesat rregullatore dhe të vetë-imponuara të kapitalit. Rreziku i valutës në portofolin e investimeve menaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së pasurive/detyrimeve. Kompania nuk ka ekspozim ndaj pasurive dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedha të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

(iii) Risku i normës së interesit

Rreziku i normave të interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të luhetet si rezultat i ndryshimit të normave të interesit në treg si dhe rreziku që maturiteti i interesave në lidhje me pasuritë ndryshojnë nga maturiteti i interesave lidhur me detyrimet e përdorura financimin e këtyre pasurive. Periudha për të cilën norma e interesit të një instrumenti financiar është e fiksuar tregon dhe ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit. Pasuritë dhe detyrimet e kompanisë mbajnë normat e interesit të tregut.

